

EC
MA NDËRYSHE

TRASHËGIMIA MBI LUMËBARDH

URAT E PRIZRENIT DHE VLERAT E TYRE



DHJETOR, 2024



TRASHËGIMIA MBI LUMËBARDH URAT E PRIZRENIT DHE VLERAT E TYRE

Botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7
www.ecmandryshe.org &
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi "Trashëgimia mbi Lumëbardh, urat e Prizrenit dhe vlerat e tyre" është realizuar në kuadër të projektit "Trashëgimia kulturore për të gjithë: Ruajtja, edukimi, zhvillimi dhe inovacioni" që zbatohet nga EC Ma Ndryshe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. HISTORIKU I NDËRTIMIT TË URAVE DHE RËNDËSIA E TYRE.....	5
3. URAT E RAJONIT TË PRIZRENIT NËN MBROJTJE TË SHTËTIT.....	6
3.1 URA E VJETËR NË GRYKËN E LUMËBARDHIT (BISTRICË).....	7
3.2 URA E VJETËR E GURIT NË PRIZREN (URA E GURIT).....	8
3.3 URA E FSHATIT BUBËL TË MALISHEVËS.....	10
3.4 URA E GURIT NË FORTESË TË RAHOVECIT.....	12
4. URAT E PRIZRENIT.....	13
4.1 URA E MANASTIRIT TE KRYE ENGJËJVE.....	16
4.2 URA E HIDROELEKTRANËS.....	17
4.3 URA E JABLLANICËS.....	18
4.4 URA E MULLIRIT TË DEHIRËVE/HAPÇIVE.....	19
4.5 URA E MARASHIT.....	20
4.6 URA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT (GANI TADËS).....	22
4.7 URA E RE E LIDHJES.....	24
4.8 URA E ARASTËS (THERANDËS).....	25
4.9 URA E NALETIT (KALTËRT).....	27
4.10 URA E RINISË (25 MAJI).....	28
4.11 URA E BELEDIJES.....	29
4.12 URA E SUZI ÇELEBISË.....	30
4.13 URA E DRURIT.....	31
4.14 URA E KAÇANIKUT.....	32
4.15 URA E BUZAGILLËKUT.....	33
5. URAT E REJA TË PRIZRENIT.....	34
6. PËRMBLEDHJA E INTERVISTAVE ME EKSPERTËT.....	37
7. REZULTATET E PYETËSORIT ME QYTETARË.....	39
7.1 PËRFUNDIMET E PYETËSORIT ME QYTETARË.....	39
7.2 ANKETË ME QYTETARËT E PRIZRENIT: MEMORIA KOLEKTIVE DHE RËNDËSIA E URAVE.....	40
8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	43
8.1 PËRFUNDIME.....	43
8.2 REKOMANDIME.....	44
9. GALERIA ME FOTO TË VJETRA TË URAVE TË PRIZRENIT.....	45
10. KOORDINATAT E URAVE.....	47
11. BIBLIOGRAFIA.....	51
12. PËR EC-IN.....	52

HYRJE

Urat janë struktura inxhinierie të ndërtuara për të lidhur dy pjesë të ndara nga pengesat natyrore ose ato artificiale. Ato janë ndërtuar për të lehtësuar lëvizjen e njerëzve, duke shërbyer si pika lidhëse midis vendeve dhe komuniteteve. Përtej funksionit të tyre praktik, urat shpesh bartin edhe vlera simbolike, kulturore dhe arkitekturore.

Urat mund të klasifikohen sipas funksionit, materialeve të ndërtimit, ose stilit të arkitekturës. Sipas funksionit dallohen urat për këmbësorë, urat për automjete, urat hekurudhore. Sipas materialeve veçohen urat prej guri, urat prej druri, ura prej çeliku ose betoni. Ndërkaq sipas arkitekturës ka ura harkore dhe ura të varura.

Rëndësia e urave gjithashtu mund të listohet në disa kategori si praktike meqë përgjatë historisë kanë lehtësuar lëvizjen e transportin, pastaj ekonomike pasi kanë mbështetur tregtinë dhe qarkullimin ekonomik, kulturore sepse janë simbole të lidhjes dhe afrimit të komuniteteve, po ashtu historike për shkak se pasqyrojnë mjeshtërinë inxhinierike të periudhave të ndryshme, dhe turistike meqë shumë ura sot shërbejnë si atraksione dhe pikë takimi për vizitorët.

Duke qenë se urat kanë një rol të shumëfishtë në jetën e një qyteti dhe shoqërie, edhe në rastin e Prizrenit, përgjatë historisë, urat kanë luajtur një rol të rëndësishëm praktik, ekonomik, kulturor, historik dhe së fundmi turistik.

Pra, roli i urave të Prizrenit është shumëdimensionale. Ato janë ura lidhjeje fizike, emocionale dhe kulturore midis së kaluarës dhe së tashmes. Përmes tyre, qyteti jo vetëm që ruan historinë e vet, por edhe përcjell një mesazh të fuqishëm për rëndësinë e kësaj trashëgimie.


Të vendosura në pika strategjike, urat e Prizrenit kanë shërbyer si lidhje të rëndësishme midis brigjeve të qytetit, duke

mundësuar komunikimin dhe bashkëveprimin mes njerëzve. Disa ura në Prizren janë vlerësuar për arkitekturën e tyre unike dhe konsiderohen si pasuri të rëndësishme kulturore dhe historike të qytetit, ndërkohë që gjatë historisë në to janë zhvilluar edhe aktivitete të rëndësishme ekonomike por edhe të socializimit.

Urat, përveçse lehtësojnë lëvizjen dhe komunikimin, gjithashtu përmirësojnë pamjen dhe atmosferën e qytetit. Ato mund të transformojnë tërësisht një hapësirë urbane, duke e bërë atë më tërheqëse dhe të këndshme për banorët dhe vizitorët. Prania e urave mund të ndihmojë në krijimin e një ndjenje lidhjeje dhe uniteti brenda komunitetit, duke theksuar rëndësinë e infrastrukturës së mirë projektuar dhe të mirëmbajtur.

EC Ma Ndryshe, me anë të këtij hulumtimi, ka për qëllim të promovojë rëndësinë dhe vlerën e urave në Prizren. Ky hulumtim është realizuar në tri pjesë. Në pjesën e parë, janë hulumtuar arkivat, librat dhe dokumentet e ndryshme mbi urat që kanë ekzistuar dhe akoma ekzistojnë në Prizren. Më pas, janë realizuar intervista me ekspertë nga fusha e historisë dhe trashëgimisë kulturore.

Në fund, është realizuar edhe një pyetësor me qytetarët e Prizrenit. Të gjitha këto përpjekje synojnë të sigurojnë një pasqyrë të qartë mbi gjendjen e urave publike dhe rëndësinë e tyre për qytetin e Prizrenit, pasi ato janë më shumë se struktura, respektivisht janë lidhje mes njerëzve, epokave dhe kulturave.



2. HISTORIKU I NDËRTIMIT TË URAVE DHE RËNDËSIA E TYRE

Urat janë ndër strukturat më të hershme inxhinierike të ndërtuara nga njerëzimi, që datojnë që nga kohët e hershme. Me kalimin e shekujve, ato kanë evoluar nga struktura të thjeshta për kalimin e pengesave natyrore, në vepra madhështore të arkitekturës dhe inxhinierisë moderne.

Historiku i ndërtimit të urave reflekton zhvillimin e shoqërive, teknologjive dhe nevojave të njerëzve. Këto ura u ndërtuan për të plotësuar nevojat bazike të kalimit, por shpesh nuk i rezistonin forcave të natyrës për shkak të materialeve të brishta që përdorshin. Megjithatë, me kalimin e kohës, zhvillimi i teknikave dhe i materialeve të reja e transformoi ndërtimin e urave.

Në Mesopotami dhe Egjiptin e lashtë, urat e ndërtuara prej tullave dhe gëlqeres u përdorën për të lidhur vendbanimet dhe për të lehtësuar tregtinë. Urat mbi Eufratin dhe Nilin ishin shembuj të hershëm të teknologjisë së përparuar në ndërtim.


Por me zhvillimin e qytetërimit romak, teknologjia e ndërtimit të urave arriti një nivel të ri. Romakët përdorën harqet dhe betonin e hershëm, që ishin rezistent ndaj ujit, për të ndërtuar ura që mund të mbijetonin për mijëvjeçarë. Ura e Alcántara në Spanjë dhe Ponte Sant'Angelo në Romë janë shembuj të inxhinierisë romake që ende admirohen sot për qëndrueshmërinë dhe bukurinë e tyre.

Në Mesjetë, ndërtimi i urave u përqendrua në strukturat prej guri. Urat gjatë periudhës mesjetare dhe Rilindjes u bënë më të sofistikuar dhe shpesh përfshinin elemente arkitektonike të bukura, si statuja dhe dekore të detajuara. Ura Charles në Pragë është një shembull i shkëlqyer i kësaj periudhe, e cila bashkonte funksionalitetin me estetikën. Kjo urë, e ndërtuar në shekullin e XIV, ishte një simbol i fuqisë dhe qëndrueshmërisë së qytetit. Në Evropë, urat mesjetare u bënë pika kyçe për zhvillimin e tregtisë.

Gjatë periudhës osmane, ndërtimi i urave mori një zhvillim të madh, duke përfshirë teknika më të avancuara dhe përdorimin e gurëve dhe llaçit. Në Prizren, dallohet Ura e Gurit, e cila është ndërtuar në shekullin e XVI dhe që prej atëherë përbën një pikë kyçe të qytetit, duke lidhur brigjet dhe duke lehtësuar qarkullimin e njerëzve. Kjo urë, me harqet e saj të forta dhe dizajnin e qëndrueshëm, shërbente jo vetëm për kalim, por edhe si një pikë takimi për tregtarët dhe qytetarët, duke mbledhur elemente të qëndrueshme të peizazhit urban dhe të jetës së përditshme. Sot është njëra prej pikë takimeve kryesore të turistëve, ku edhe realizohen fotografitë për kujtim nga qyteti i vjetër.

Me zhvillimin e teknologjisë, ka filluar edhe përdorimi i çelikut dhe hekurit në ndërtimin e urave, si pjesë e rëndësishme e zhvillimit urban dhe ndërlidhjes së qyteteve të mëdha, duke shërbyer si urë lidhëse për tregti dhe transport.

Historiku i ndërtimit të urave është një tregim i zhvillimit teknologjik dhe shoqëror të njerëzimit. Nga strukturat e thjeshta prej druri e guri, deri te veprat inxhinierike bashkëkohore, urat kanë shërbyer si simbole të lidhjes, përparimit dhe bashkëpunimit. Ato vazhdojnë të jenë dëshmi e aftësisë njerëzore për të kapërcyer kufijtë natyrorë dhe për të ndërtuar lidhje të qëndrueshme midis vendeve dhe njerëzve.



3. URAT E RAJONIT TË PRIZRENIT NËN MBROJTJE TË SHITETIT

Në rajonin e mbuluar nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren gjithsej katër ura gëzojnë mbrojtje institucionale si monumente të trashëgimisë kulturore. Dy ura të vjetra prej gurit ndodhen në territorin e Komunës së Prizrenit, derisa e treta ndodhet në fshatin Bubël të Komunës së Malishevës dhe Ura e Gurit në Rahovec, të cilat gjithashtu kanë vlera të shtuara të trashëgimisë kulturore.

- 3.1 URA E VJETËR NË GRYKËN E LUMËBARDHIT (BISTRICË)



- 3.2 URA E VJETËR E GURIT NË PRIZREN (URA E GURIT)



- 3.3 URA E FSHATIT BUBËL TË MALISHEVËS



- 3.4 URA E GURIT NË FORTESË TË RAHOVECIT



3.1 URA E VJETËR NË GRYKËN E LUMËBARDHIT (BISTRICË)

Ura e vjetër në grykën e Lumëbardhit, e vendosur në kilometrin e 6-të të rrugës Prizren-Reçan, kalon mbi Lumëbardh në një nga pikat më të ngushta të rrjedhës së lumit. Kjo urë, me gjatësi 20 metra dhe gjerësi 3.3 metra, është ndërtuar mbi shkëmb gëlqeror dhe ka vetëm një qemer të lartë 6 metra mbi nivelin e ujit, me një hapësirë prej 13 metrash. Muret anësore janë ndërtuar me gurë të gdhendur. Traseja e urës është e shtruar me kalldrëm. Ura ka një trajtim të pasur artistik e estetik dhe përshtatet në peizazhin shkëmbor të Grykës së Lumëbardhit që shtrihet në horizontin e saj.

Ura është shpallur monument kulturor sipas vendimit nr. 1149/56 të Entit Rajonal për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore. Aktualisht është monument nën mbrojtje të përhershme.

Kjo urë, sipas shënimeve në Databazën e Trashëgimisë Kulturore është ndërtuar në aksin e rrugës së vjetër e cila nisej nga Prizreni, përgjatë grykës së Lumëbardhit, e nëpër malin e Sharrit dilte në luginën e Vardarit, për në Shkup e tutje. Pra, prej kohësh, nëpërmjet kësaj rruge është zhvilluar komunikacioni dhe tregtia ndërmjet Prizrenit e Shkupit dhe anasjelltas. Për kohën e ndërtimit të saj nuk ka të dhëna as gojore e as të shkruara, por në DTK shkruan se në bazë të ngjashmërisë së saj me Urën e Gurit të Qytetit, vihet në përfundim se këto dy ura janë kohanikë, në fund të shek. XV, ose në fillim të shek. XVI.

Me asfaltimin e rrugës dhe ndërtimin e urës së re, më 1955, që kalon fare pranë Urës së Vjetër, ndryshojnë rrethanat. Ura e Vjetër e humb funksionin primar që e ushtronte ndër shekuj, dhe bëhet joaktive, ndërkaq kjo gjendje sipas DTK reflektohet edhe në kujdesin e shoqërisë ndaj saj. Ndonëse është ndër monumentet e rralla origjinale që ka mbërrirë në ditët tona, ajo nuk mirëmbahet.

Gjendja e saj sipas DTK është kritike, traseja e urës është e mbushur me zhavorr e barishte, skajoret janë dëmtuar, ka edhe dëmtime tjera strukturale, etj. Me karakteristikat që i përmban kjo urë i takon grupit të urave të periudhës osmane të ndërtuara në këtë rajon. Sipas DTK paraqet ndërtimin e vetëm të këtij lloji, që është ruajtur në gjendje origjinale deri në ditët e sotme, dhe si të tillë ka vlera të larta arkitektonike dhe shkencore.



Fig.1. Ura e Vjetër e Gurit - Katërdhjetbunar



Fig.2. Ura e Vjetër e Gurit - Katërdhjetbunar



Fig.3. Ura e Vjetër e Gurit - Katërdhjetbunar (M.Shukriu)

3.2 URA E VJETËR E GURIT NË PRIZREN (URA E GURIT)

Lumëbardhi i Prizrenit ndan qytetin në dy pjesë pothuajse të barabarta, duke e bërë lumin një element qendror të peizazhit urban. Mbi rrjedhën e tij, gjatë shekujve, janë ndërtuar shumë ura, por më e famshmja dhe më e dashura është Ura e Gurit, e cila është shndërruar në një simbol të qytetit. E vendosur në qendrën e qytetit të vjetër, Ura e Gurit lidh drejtpërdrejt sheshin Shatërvan me Saraçhanën, duke bashkuar pjesët kryesore të qytetit. Nga ana lindore e saj ndodhet Ura e Arastës, ndërsa nga perëndimi Ura e Naletit. Sipas DTK deri më tani nuk dihet për kohën dhe ndërtuesin e urës, por bazuar në stilin dhe teknikën e ndërtimit ajo i takon periudhës klasike Osmane dhe duhet të jetë e ndërtuar diku në pjesën e parë të shekullit XVI.

Struktura e vjetër e urës ishte ndërtuar me gurë cilësorë të përpunuar, të lidhur fort me llaç gëlqeror. Fillimisht, ura kishte tre harqe: harku i mesëm ishte më i madh, ndërsa dy harqet anësore ishin më të vogla. Gjatësia e urës së dikurshme ishte rreth 30 metra,

ndërsa ura e tanishme është më e shkurtër, me një gjatësi prej 17 metrash. Harku qendror ka një gjatësi prej 10 metrash dhe një lartësi prej 5 metrash, ndërsa harqet anësore janë të gjatë 4 metra dhe të lartë 3 metra. Ura ka gjithashtu një hark të vogël ndihmës me përmasa 103 cm gjatësi dhe 160 cm lartësi. Gjerësia e trasesë është 4.20 metra dhe është e shtruar me kalldrëm, ndërsa rrethojat e saj prej 40 cm ndjekin nivelimin e strukturës.

Përgjatë shekujve, Ura e Gurit ka përjetuar disa ndryshime të mëdha dhe dëmtime strukturore. Në vitet 1960, gjatë rregullimit të shtratit të Lumëbardhit, u dëmtua harku i saj i majtë, ndërsa harku i djathtë u prek gjatë ndërtimit të rrugës së re në vitin 1963. Më 17-18 nëntor 1979, një vërshim i fuqishëm i lumit shkaktoi shkatërrimin e plotë të urës. Mobilizimi i qytetarëve dhe autoriteteve dërgoi në vendimin për rindërtimin e urës. Më 5 qershor 1982, filluan punimet për restaurimin e saj, sipas projektit të inxhinierit



fig.4 Ura e Gurit në vitin 1954 (burimi: M.Shukriu)

M. Gojković, të mbikëqyrura nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore të Prizrenit. Punimet u kryen nga Ndërmarrja "Elan," dhe më 17 nëntor 1982, ura e rindërtuar u inaugurua, duke rikthyer natyrshëm në peizazhin e saj të vjetër dhe duke rifilluar funksionin e saj si urë për këmbësorë. Duke marrë parasysh vlerat e saj historike dhe kulturore, Ura e Gurit është vënë nën mbrojtje shtetërore që nga 31 dhjetori 1948, me vendimin nr. 2345. Ajo vazhdon të mbetet një simbol i trashëgimisë kulturore të Prizrenit dhe një pikë lidhjeje e pandashme e historisë së qytetit.



fig.5 Pamje panoramike e Urës së Gurit



fig.6 Ura e Gurit, pamja nga shkallët

3.3 URA E FSHATIT BUBËL TË MALISHEVËS

Ura e Bublilit, e ndërtuar mbi lumin Mirushë, lidh fshatrat Bubël dhe Çupevë dhe përfaqëson një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të rajonit. Përveç urës, në këtë zonë ndodhen edhe rrënojat e mullirit të fshatit, hambari i vjetër dhe varrezat e lashta, duke krijuar një peizazh të pasur historik që ka mbijetuar përmes kohëve. Sipas një pllake mermeri me mbishkrim, mësohet se në vitin 1883, Hamzë Këpuska nga Gjakova e ka rinovuar urën, duke lënë një kontribut të vlefshëm për komunitetin lokal.

Gojëdhënat tregojnë se ndërtimi fillestar i urës daton nga shekulli XVIII dhe është realizuar nga familja Kusari. Hamzë Këpuska, si pasardhës i kësaj familjeje, e rinovoi strukturën në fund të shekullit XIX. Ura ka pasur një rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës, duke shërbyer si pjesë e një rruge tregtare që lidhte Gjakovën me Vushtrrinë. Kjo tregon se një strukturë e mëparshme ndoshta ka ekzistuar në këtë vend edhe para vitit 1883.

Nga ndërtimi fillestar e deri në vitet '60 të shekullit XX, ura ka qenë në përdorim të

vazhdueshëm. Megjithatë, pas ndërtimit të një ure të re prej betoni pranë saj, ura e vjetër u braktis dhe nisi të degradohej. Dridhjet e shkaktuara nga trafiku mbi urën e re, së bashku me përmytjet e shpeshta, kontribuuan në dëmtimin e rëndë të strukturës, duke shkaktuar shembjen e harqeve anësore, zhdukjen e traseve të ecjes dhe shkatërrimin e dritareve shkarkuese të urës. Deri në vitet '80 të shekullit XX, nga ura mbeti vetëm harku qendror. Në vitin 2002, ura u evidentohet si monument kulture nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë e Prizrenit, dhe në vitin 2009 filluan punimet për restaurimin, konservimin dhe rikonstruksionin e saj. Ky proces u përfundua në shtator të vitit 2010, duke rikthyer urën në gjendjen e saj të mëparshme. Punimet përfshinë rindërtimin e plotë të urës përveç harkut qendror, i cili ishte elementi i vetëm i ruajtur origjinal. Restaurimi përfshinte konservimin e harkut origjinal, përforcimin e themeleve dhe rindërtimin e pjesëve të tjera duke u bazuar në foto-dokumentacionet dhe gërmimet që zbuluan themelet ekzistuese.



Fig.7. Ura e Fshatit Bubël.



Fig.8. Ura e Fshatit Bubël.

Ura e Bublilit është një shembull karakteristik i urave me harqe të rajonit, të ndërtuara në shekujt XVIII dhe XIX me material lokal. Struktura përbëhet nga katër harqe, me harkun qendror që ka një diametër prej 8.35 metrash, ndërsa harqet anësore kanë dimensione 3.85, 3.0 dhe 1.65 metra. Gjatësia totale e urës është 30 metra dhe gjerësia 3.2 metra. Harku kryesor është i pajisur me dy dritare shkarkuese që lehtësojnë rrjedhën e ujit, një element i rëndësishëm hidro-

inxhinjrik për shkak të përmbytjeve të shpeshta në zonë.

Ndërtimi i urës është bërë me gurë të zinj, ndërsa traseja e ecjes është shtruar me gurë lumi dhe pllaka të vendosura në dy anët. Restaurimi i viteve 2009-2010 përfshiu ruajtjen e harkut qendror dhe rindërtimin e plotë të pjesëve të tjera, duke siguruar që ura të rifitojë rolin e saj si një monument kulturor i rëndësishëm dhe një dëshmi e arkitekturës së vjetër në rajon.



Fig.9. Ura e Fshatit Bubël.

3.4 URA E GURIT NË FORTESË TË RAHOVECIT

Ura e Fortesës është ndërtuar mbi lumin Remnik, i cili përshkon fshatin me të njëjtin emër, që gjendet rreth 7 kilometra në jugperëndim të Rahovecit. Duke u bazuar në teknikën e ndërtimit, materialet dhe formën arkitektonike, supozohet se ura daton që nga shekulli XVI. Kjo urë ka qenë një element i rëndësishëm i infrastrukturës lokale, duke shërbyer vazhdimisht për banorët e zonës që nga koha e ndërtimit deri më sot.

Struktura e urës përfshin një hark të vetëm me një diametër prej 7 metrash, një gjatësi totale prej 10.7 metrash dhe një gjerësi rreth 4 metra. Harku është ndërtuar në dy rreshta nga gurët shpuzore, të njohur si "siga", ndërsa pjesa e sipërme e strukturës është realizuar me gurë gëlqerorë të thyer, të lidhur me llaç gëlqeror. Traseja fillimisht ishte e shtruar me kalldrëm, duke ruajtur karakterin tradicional të ndërtimit, por në fund të shekullit XX u nivelua dhe u shtrua me pllakë betoni për t'iu përshtatur transportit motorik, duke përjetuar kështu një transformim të funksionalitetit të saj.

Rreth 150 metra në verilindje të urës së Fortesës gjendet edhe një urë tjetër prej guri me dimensione më të vogla, e cila sugjeron se zona ka pasur një rëndësi të veçantë për lidhjen e rrugëve dhe komunikimin në të kaluarën. Prania e lokalitetit arkeologjik nga periudha romake dhe dy urat prej guri janë dëshmi materiale për historinë e vjetër të këtij vendi dhe për zhvillimet urbanistike që kanë ndodhur këtu që nga kohërat e hershme romake dhe mesjetare.

Në vitin 2011, për të mbrojtur lumin Remnik nga erozioni dhe për të integruar më mirë urën e vjetër në peizazhin e zonës, muret rrethuese të lumit u ndërtuan me gurë gëlqerorë. Ky restaurim e bëri urën pjesë të një kompleksi më të gjerë, duke krijuar një peizazh kulturor të veçantë që përmbledh elementet tradicionale dhe moderne të ndërtimit. Ky peizazh reflekton një ndërthurje të vlerave historike dhe arkitektonike, duke mbajtur gjallë kujtesën e zhvillimeve urbanistike dhe të historisë së zonës.



Fig.10. Ura e Gurit – Fortesë/Rahovec.



Fig.11. Ura e Gurit – Fortesë/Rahovec



Fig.12. Ura e Gurit – Fortesë/Rahovec

4. URAT E PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit ka gjithsej 25 ura, prej të cilave vetëm dy sosh gëzojnë mbrojtje institucionale: Ura e Vjetër në Grykën e Lumëbardhit dhe Ura e Gurit në qendër të qytetit. Por disa ura ndodhen në zonën e mbrojtur historike të Prizrenit, e cila trajtohet me ligj të veçantë.

Nga 25 urat, 14 prej tyre janë ura të vjetra me vlera historike, të ndërtuara për nevojat e qytetarëve, por që ende nuk janë njohur formalisht si pjesë e trashëgimisë kulturore të qytetit. Në vitet e fundit, përgjatë Lumëbardhit janë ndërtuar edhe 9 ura të reja, të cilat dallojnë nga ato të mëparshmet për shkak të përdorimit të konstruksioneve prej metali dhe bazamenteve prej druri. Këto ura moderne plotësojnë nevojat e qarkullimit urban dhe ofrojnë një integrim të materialeve bashkëkohore në peizazhin natyror dhe urban të Prizrenit.

□ 4.1 URA E MANASTIRIT TË KRYE ENGJËJVE



□ 4.2 URA E HIDROELEKTRANËS



□ 4.3 URA E JABLLANICËS



□ 4.4 URA E MULLIRIT TË DEHIRËVE/HAPÇIVE



URAT E PRIZRENIT	NUMRI I URAVE
URAT NËN MBROJTJE	2
URAT E VJETRA	14
URAT E REJA	9
TOTALI	25

□ 4.5 URA E MARASHIT



□ 4.6 URA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT (GANI TADËS)



□ 4.7 URA E RE E LIDHJES



□ 4.8 URA E ARASTËS (THERANDËS)



□ 4.9 URA E NALETIT (KALTËRT)



□ 4.10 URA E RINISË (25 MAJI)



□ 4.11 URA E BELEDIJES



□ 4.12 URA E SUZI ÇELEBISË



□ 4.13 URA E DRURIT



□ 4.14 URA E KAÇANIKUT



□ 4.15 URA E BUZAGILLËKUT



4.1 URA E MANASTIRIT TE KRYE ENGJËJVE



fig.13 Ura e Manastirit të Kryeengjyje (burimi: M.Shukriu)

Ura është ndërtuar ndërmjet viteve 1967-68 në emër të rekonstruktimit të urës së vjetër të manastirit të Kryeengjyje edhe pse nuk dihej se çfarë pamje ka pasur ajo. Ura është ndërtuar nga Enti Krahinor për Mbrojtje të Përmendoreve Kulturore në Prishtinë dhe ka qenë e vetmja rrugë për tu çasur rrënojave të manastirit. Institucionet e kulturës të kohës ndër tjera kishin në plan të aktivizojnë edhe manastirin e Kryeengjyje si aset kulturor dhe për këtë qëllim krijonin kushte dhe infrastrukturë. Bazuar në të dhëna historike thuhej se manastiri ka pasur një urë nga ana veriore dhe pas gërmimeve dhe hulumtimeve të bëra ekspertët e zbulojnë disa gjurmë të urës së vjetër por që nuk aludon në formën dhe drejtimin që ka pasur. Përkundër mangësive informacioni për dukjen, madhësinë dhe formën që ka pasur ura, është vendosur që të ndërtohet një urë me tipare mesjetare duke marr për bazë edhe karakteristikat e urës së Kërk Bunarit dhe urës së gurit.



fig.14 Pamja ballore e Urës së Manastirit të Kryeengjyje



fig.15 Pamja anësore e Urës së Manastirit të Kryeengjyje

4.2 URA E HIDROELEKTRANËS



fig.16 Ura e Muzeut të Hidroelektranës

Ura "Prizrenasja" u ndërtua në vitin 1929, në të njëjtën kohë me hidrocentralin që ndodhet pranë saj, për të cilin ajo shërbente si urë funksionale. Fillimisht, ura ishte e ndaluar për publikun dhe shfrytëzohej ekskluzivisht për nevojat e hidrocentralit, duke qenë pjesë e rëndësishme e infrastrukturës energjetike të rajonit. Me kalimin e kohës, hidrocentrali u transformua në Muzeun e Elektro-ekonomisë së Kosovës, duke i dhënë urës një rol të ri, atë të një lidhjeje historike dhe turistike. Përveç muzeut, në afërsi të urës u hap edhe një bufe-restorant që tërheq vizitorët, duke e bërë urën dhe muzeun një kombinim të veçantë të trashëgimisë industriale dhe përvojës kulturore. Ura ka rëndësi të veçantë në aspektin e trashëgimisë kulturore për faktin se është e vetmja urë si tërësi e trashëguar nga periudha mes Dy Luftërave Botërore që karakterizohet edhe me stilin dhe materialet e ndërtimit.



fig.17 Pamje nga afër e urës së Muzeut të Hidroelektranës fig.18 Ura dhe objekti i Muzeut të Hidroelektranës

4.3 URA E JABLLANICËS

Ura e Jabllanicës në të kaluarën ka qenë mbase prej druri që ka lidhë fshatrat e zonës (Pousko, Jabllanicë, Lez, etj) me fshatrat tjerë të rajonit të Zhupës e veçmas me Prizrenin. Ndër vite nga kushtet natyrore e sidomos nga vërshimet ura është dëmtuar dhe rrënuar, andaj edhe është riparuar dhe rindërtuar disa herë.

Me material të fortë (beton-arme) ura është rindërtuar diku në vitin 1976 me investimin e televizionit të Prishtinës dhe me kontributin e banorëve të fshatrave të zonës. Duke qenë se rruga për antenën e TV-së që ndodhej në majën e Cvilenit kalon përmes kësaj zone ishte në interes të televizionit të investoj në rrugën dhe urën që qon deri te antena. Pas luftës së fundit kur TV antena nuk ishte më (është bombarduar nga NATO-ja) bie edhe interesimi në mirëmbajtjen e rrugës dhe urës e cila degradohet tejmas. Kjo gjendje ka vazhduar derisa nuk është rindërtuar ura e re e cila është përruruar solemnisht me 26.11.2015 duke lidhë Prizrenin me fshatin Pousko, Jabllanicë dhe me fshatin Lez e më tej.



fig.19 Ura e Jabllanicës

Kjo urë mbase ka rëndësi lokale për qarkullimin e banorëve të fshatrave të rajonit me Prizrenin, ajo është rindërtuar edhe si rrjedhojë e fushatave politike. Natyrisht që ura ka lehtësuar qarkullimin jo vetëm të banorëve të fshatrave që frekuentojnë Prizrenin por edhe anasjelltas ku banorët e zonave urbane e kanë më lehtë qasjen në rajonin malor me të mirat që ajo ofron, si fshatrat Pousko, Jabllanicë, Lez dhe zonën turistike në Shtëpinë Malore. Ka rëndësi sociale dhe turistike-rekreative në mënyrë indirekte. Natyrisht që ka ndikim edhe në mirëqenien e banorëve të kësaj zone meqë përmes infrastrukturës rrugore mundëson qasjen më të lehtë në qytet dhe lëvizjen e njerëzve dhe mallrave.



fig.20 Ura e re Jabllanicës

4.4 URA E MULLIRIT TË DEHIRËVE/HAPÇIVE

E njohur gjithashtu si Ura e "Brioneve", u ndërtua fillimisht prej druri në vitet 1940-1941, së bashku me mullirin që gjendej pranë saj. Pas Luftës së Dytë Botërore, mulliri u sekuestrua, dhe filluan të ndodhin dëmtime të vazhdueshme si të mullirit ashtu edhe të urës. Në vitet 1954-1955, mulliri u shndërrua në një kafe-restorant të quajtur "Brioni", dhe gjatë këtij transformimi, ura u riparua për të vazhduar funksionin e saj. Në vitet 1964-1965, pas kalimit të pronësisë së objektit në duart e një pronari privat, ura u rindërtua me një strukturë më të fortë prej beton-armature. Ky rindërtim i dha urës një jetë të re dhe një funksionalitet më të sigurt, por gjithashtu e largoi nga pamja dhe materiali origjinal prej druri, duke i dhënë një pamje më moderne dhe praktike. Megjithatë, pavarësisht transformimeve të saj, Ura e "Brioneve" ruan një lidhje historike me periudhën e hershme të ndërtimit dhe zhvillimit të zonës, duke shërbyer si një dëshmi e ndryshimeve të vazhdueshme të kohës dhe funksionit të saj. Për një periudhë të gjatë, ura pësoi dëmtime të ndryshme për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së duhur. E njohur ndryshe



Fig.21. Ura Mullirit të DEHIRËVE/HAPÇIVE 1996 M.Shukriu

edhe si "Ura e Mullirit", ajo mbetet e frekuentuar nga qytetarët, pasi është pjesë e shtegut për në kalanë e Prizrenit. Shfrytëzimi i saj i madh për kalimtarët nxiti një rindërtim të plotë për arsye sigurie. Ura prej beton-armature u zëvendësua me një konstruktion të ri metalik dhe bazament prej druri, duke i dhënë një pamje të freskët dhe të përshtatshme për mjedisin, duke ruajtur kështu rëndësinë e saj për komunitetin dhe historinë lokale.



Fig.22. Ura Mullirit të DEHIRËVE/HAPÇIVE.



Fig.23. Ura Mullirit të DEHIRËVE/HAPÇIVE.

4.5 URA E MARASHIT

Ura e Marashit nuk dihet se kur është ndërtuar për herë të parë. Nga burimet e ndryshme kuptojmë se ura ka qenë prej druri dhe nga vërshimet e vitit 1806/7 ajo është shkatërruar. Më vonë ura sërish rindërtohet prej druri e cila sërish shkatërron nga vërshimet në vitin 1938. Pas Luftës së Dytë Botërore ura e Marashit rindërtohet disa dhjetëra metra më poshtë (në perëndim) ku gjendet edhe tani. Mbajtësit ('këmbët') e urës ndërtohen prej guri ndërsa bazamenti (traseja) prej druri si një zgjidhje e përkohshme.

Në vitin 1968, ura mori një transformim të rëndësishëm kur u vendosën shina hekuri mbi bazamentin e mëparshëm dhe dyshemeja prej druri u zëvendësua me beton, duke i dhënë urës qëndrueshmëri dhe siguri më të madhe. Gjithashtu, u ngritën rrethojat e urës, duke e bërë atë më të sigurt për këmbësorët. Ky transformim i dha urës "Çaxhir" një pamje dhe funksionalitet më modern, duke ruajtur një pjesë të historisë së saj të gjatë dhe rolin e saj si një lidhje kyçe në zonën përreth.



fig.24 Fotografi e vjeter e urës së Marashit



fig.25 Fotografi e vjeter e urës së Marashit

Nga mosmirëmbajtja sistematike dhe nga vërshimet e vitit 1979 kjo urë edhe pse përballon ujërat katastrofike ajo në masë të madhe dëmtohet. As pas kësaj nuk bëhet ndonjë rregullimi i mirëfilltë derisa në vitin 2003 ajo rrënohet për tu rindërtuar ura e re që nuk përputhet me konceptin e urave tradicionale të qytetit e as me urat bashkëkohore-moderne. Kjo urë ka qenë e rëndësishme për banorët e lagjes Ralin dhe të Kurillës që frekuentonin lagjen Marash (dhe anasjelltas) për të vizituar xhaminë e Maksut Pashës apo teqenë e tarikatit Saadi, por edhe për pemishtet dhe vreshtat që kanë pasur qytetarët rrëzë Kalasë.

Vitet e fundit janë bërë disa ndërhyrje të tjera në urën e Marashit, ku është rritur bazamenti i saj për të përmirësuar stabilitetin. Përveç funksionit tradicional të lidhjes së mëhallës së Ralinit me kompleksin e Marashit, janë shtuar edhe disa ulëse, duke e bërë urën një vend për relaks dhe pushim për qytetarët. Kjo është ura e vetme në Prizren që ofron një mundësi të tillë, edhe pse ka një sipërfaqe të gjerë, ajo mbetet e hapur vetëm për këmbësorët dhe jo për qarkullimin e automjeteve.

Në vitet e fundit, komuna ka investuar në përmirësimin e pamjes së urës. Përveç rrethojave prej druri, janë shtuar disa shtylla gurësh, të cilat kontribuojnë në qëndrueshmërinë e strukturës, duke i dhënë urës një pamje më të integruar me mjedisin dhe një aspekt estetik të përmirësuar.



fig.26 Hapësirat relaksuese në urën e Marashit



fig.27 Pamje e urës së Marashit

4.6 URA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT (GANI TADËS)



Fig.28. Ura e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit M.Shukriu

Ura ndodhet në kompleksin përmendor "Marash" dhe shërben si lidhje mes këtij kompleksi dhe kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (LSHP). Gjatë viteve 1878-1881, ajo luajti një rol të veçantë në ngjarjet e rëndësishme kombëtare, duke lidhur dy brigjet dhe duke u njohur që atëherë si Ura e Lidhjes. Në atë kohë, ura kishte një konstruktion të gjerë dhe të qëndrueshëm, duke reflektuar rëndësinë e saj në historinë kombëtare.


Deri në vitin 1946, konstrukcioni i epërm i urës ishte prej druri, por gjatë viteve 1948 u rindërtua me një strukturë të ngushtë druri, e përshtatur për kalimtarët. Pasi kjo urë e rindërtuar u shkatërrua, pika e kalimit mbeti pa urë për disa dekada, duke detyruar kalimtarët të kalonin mbi ujësjellësin e betonuar dhe duke vënë në rrezik jetën e tyre. Ura e tanishme u ndërtua në vitin 1994 mbi fundamentin e mesëm ekzistues, ku u përdor beton-armatura për strukturën e re. Skajet e urës janë pajisur me saks për mbjellje prej beton-armature, ndërsa dyshemeja është mbuluar me pllaka guri natyror, duke i ofruar urës një pamje të fortë dhe natyrale.

Ura është e dedikuar ekskluzivisht për këmbësorët, dhe për këtë arsye në të dy anët e saj janë vendosur shtylla hekuri për të kufizuar qarkullimin e mjeteve. Në pjesën veriperëndimore janë ndërtuar shkallët për të lehtësuar kalimin.

Duke qenë pjesë e një kompleksi të pasur me trashëgimi kulturore dhe natyrore, ura nuk pengon përjetimin vizual të vlerave arkitekturore dhe natyrore të zonës, megjithëse akueduktet dhe fundamenti i mesëm i saj nuk i përshtaten plotësisht tendencave bashkëkohore për të ruajtur një vulë kohore të vlefshme në thesarin trashëgimor të qytetit.



Fig.29. Ura e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit M.Shukriu



Në projektin urbanistik të vitit 1969 për rregullimin e shtratit të Lumëbardhit nga Marashi deri tek Ura e Gurit, kjo urë ishte një nyje e komplikuar për shkak të vlerës dhe funksionalitetit të saj të dyfishtë. Përpjekjet për të realizuar një urë me dimensione më moderne dhe atraktive përfshinë shumë disiplina shkencore e teknike, por mungesa e financimeve dhe skepticizmi për arritjen e një strukture që do të mbartte vlerat materiale të kohës bënë që ndërtimi i urës të mbetet i papërfunduar, ndërsa rregullimi i shtratit të Lumëbardhit u realizua. Ura ka mbetur si një nyje simbolike dhe funksionale, duke mbartur me vete historinë dhe evoluimin e saj në përputhje me ndryshimet urbane të qytetit të Prizrenit.



Fig.30. Ura e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.



Fig.29. Ura e vjetër dhe re e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Gjatë hartimit të planit për rigjenerimin e brigjeve të Lumëbardhit në vitin 2021 kjo urë ishte propozuar që të mbulohet me çati si imitim i urës së 'Arastës' (Therandës). Ndërtimi i urës ka pasur rëndësi mbase në kohën kur ka qenë aktiv medreseja e Gazi Mehmed Pashës por edhe lidhja e lagjes marash me zonën veriore të qytetit. Duhet pasur parasysh se lugjet e ujit mbështeteshin në strukturë e kësaj ure.

4.7 URA E RE E LIDHJES

Pas zhvillimit urbanistik dhe rritjes së kërkesës për automjetet e banorëve të kompleksit Marash është ndjerë nevoja për ndërtimin e një ure të re afër urës së vjetër të Lidhjes. Deri sa është ndërtuar Ura e re e Lidhjes banorët për qasje në kompleksin e Marashit me automjetet e kanë shfrytëzuar urën e Marashit. Në vitet 1994-1996 rindërtohet ura e re e Lidhjes, ku pas luftës ura rinovohet dhe riparohet dhe zgjerohet në të dyja anët megjithëse ende në vend ishte ura e vjetër e cila është e shfrytëzueshme vetëm për këmbësorët, ndërsa ura e re, e ndërtuar afër saj, është e hapur edhe për qarkullimin e mjeteve automobilistike.

Kjo urë e re është ndërtuar me beton-armaturë, duke ruajtur një strukturë të ngjashme me atë të urës së vjetër. Megjithatë, anësoret e urës dhe bazamenti janë kamufluar me gurë, për t'u përshtatur dhe harmonizuar me ambientin rrethues. Ky detaj dizajni tregon një përpjekje për të ruajtur estetikën lokale dhe për të siguruar që ura të integrohet në peizazhin natyror dhe kulturor të zonës, duke ofruar një zgjidhje moderne për nevojat e përditshme të komunitetit.




Fig.32. Ura e re e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

4.8 URA E ARASTËS (THERANDËS)

Ura e Arastës, e njohur më vonë si Ura e Therandës, është një nga strukturat më të vjetra dhe më të rëndësishme të Prizrenit, duke mbajtur një vend të posaçëm në kujtesën historike dhe kulturore të qytetit. Kjo urë, ndërtuar gjatë periudhës osmane, lidhesh ngushtë me çarshinë e Prizrenit dhe luante një rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe social të qytetit. Emri "Arasta" vjen nga fjala persiane që do të thotë "e mbuluar," dhe kjo reflektohej në strukturën e urës, e cila kishte çati prej qeramidheve turke dhe kashtë, dhe në të dyja anët e saj ndodheshin dyqane zejtare, kryesisht terzishte, duke e bërë urën një pikë të rëndësishme tregtare. Në shekullin XVIII, ura kishte tre harqe prej guri dhe ishte një urë e mbuluar me kulm, duke u veçuar nga urat e tjera të qytetit për funksionin e saj tregtar. Dokumentacioni historik sugjeron se ura mund të jetë ndërtuar nga Ali Beu, babai i Sinan Pashës, dhe ishte një nga katër urat e ndërtuara në Prizren në atë periudhë. Sipas të dhënave, ura ishte ndërtuar para vitit 1795, dhe gjatë viteve ajo u bë një simbol i Prizrenit si urë



Fig.34. Ura e Therandës



Fig.33. Ura e Therandës 1996 M.Shukriu

tregtare dhe vend i rëndësishëm kalimi për qytetarët dhe tregtarët që përdornin këtë rrugë për të transportuar mallra dhe për të bërë tregti

Fatkeqësisht, ura dhe dyqanet e saj pësuan dëme të rënda nga zjarret që shpërthyen në vitin 1853 dhe më vonë në vitin 1912, duke shkatërruar plotësisht strukturën dhe tregtinë e gjallë që zhvillohej aty. Pas këtyre fatkeqësive, ura u rindërtua fillimisht me strukturë druri si një zgjidhje e përkohshme. Më vonë, në vitin 1936, u ndërtua një urë e re prej beton-armature, me dysheme të shtruar me kubza graniti dhe trotuare betoni, duke e përshtatur për kalimin e automjeteve të lehta dhe qerreve që transportonin mallra. Ky rindërtim modern e ndryshoi ndjeshëm pamjen dhe funksionalitetin e urës, dhe emri i saj u ndryshua në "Ura e Therandës" për shkak të ndërtimit të hotelit me të njëjtin emër pranë urës.

Kujtesa e Urës së Arastës mbeti e gjallë në mendjet e qytetarëve të Prizrenit, për shkak të rëndësisë së saj në jetën tregtare dhe sociale të qytetit. Në vitin 2016, organizata EC Ma Ndryshe organizoi një performancë publike me titullin "I AM MONUMENT" për të rikujtuar vlerën e urës dhe për të theksuar rëndësinë e saj si një simbol i trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Performanca kishte për qëllim të sillte në vëmendje historinë e çarshisë dhe zhvillimin ekonomik të dikurshëm që lidhej me këtë strukturë.

Sot, pozita e Urës së Therandës ruan rëndësinë strategjike, duke lidhur zonën e Shadërvanit dhe Kalasë me pjesën tjetër të qytetit, dhe duke ndërlidhur rrugët kryesore regjionale. Megjithëse struktura e saj aktuale është modernizuar dhe përshtatur për kërkesat e qarkullimit bashkëkohor, ura mbetet një simbol i Prizrenit dhe një dëshmi e historisë së tij të pasur ekonomike, shoqërore dhe arkitektonike.



Fig.35. Ura e Arastës 1875.



Fig.36. Ura e Therandës (Fotografuar gjatë performancës I AM MONUMENT).

4.9 URA E NALETIT (KALTËRT)



Fig.37 Ura e Naletit (Kaltërt) 1996 M.Shukriu

Ura e Naletit, e vendosur pak më poshtë se Ura e Vjetër e Gurit, është një tjetër urë e vjetër dhe e njohur e Prizrenit. Për shkak të konstruksionit fillestar prej druri, ura ishte e ndjeshme ndaj rrënimeve të shpeshta nga vërshimet e ujërave të Lumëbardhit, dhe për këtë arsye mori emrin e saj të veçantë, Ura e Lanetit (Ura e Djallit).

Në vitin 1956, konstruksioni i saj u përmirësua me një strukturë montazhi prej pllakave të beton-armaturës, qëndruar kështu deri në vërshimet e mëdha të 19 nëntorit 1979. Pas kësaj fatkeqësie natyrore, ura aktuale u ndërtua në vitin 1980. Ky version i urës ka një konstruksion të fortë prej beton-armature, i cili mbështetet drejtpërdrejt në brigjet e murëzuara të Lumëbardhit, me anësore prej hekuri të salduar dhe një dysheme të drejtë të shtruar me pllaka të profiluara. Ashtu si paraardhësja e saj, ura shërben ekskluzivisht për këmbësorët.

Gjatë diskutimeve për projektimin e urës së re, të organizuara nga kryetari i atëhershëm i Komunës së Prizrenit, Salajdin Skeja, u sugjerua që ura të përfshinte elemente filigrane dhe një platformë pushimi në trajtë harku në anën lindore. Kjo platformë do të shërbente si një pikë përjetimi vizual të monumenteve të qytetit, si Kalaja e Prizrenit,

Ura e Gurit, Xhamia e Sinan Pashës, dhe do të krijonte një lidhje vizuale dhe kompozicionale me arkitekturën tradicionale të qytetit, veçanërisht me çardakun e mbyllur të shtëpisë së Shuaip Pashës që ndodhet përballë.

Pavarësisht sugjerimeve të vlefshme për t'i dhënë urës një karakter estetik dhe historik të përputhshëm me ambientin, projekti i realizuar nuk i mori parasysh këto rekomandime. Ura e tanishme, edhe pse e dizajnuar për t'u përshtatur me hapësirën, nuk arriti të përmbushë plotësisht synimet estetike dhe arkitektonike të propozuara. Struktura aktuale, ndonëse funksionale dhe e sigurt, nuk arrin të integrohet plotësisht në mjedisin historik të qytetit dhe mungon finesa e stilit që do t'i përshtatej bukurisë arkitektonike dhe traditës së Prizrenit.

Ura e Naletit nuk ka pësuar ndryshime në formë apo strukturë, por në vitin 2015, me iniciativën e organizatës EC, ajo mori një epitete të ri duke u shndërruar në "Ura e Dashurisë." Për plot gjashtë vite, kjo urë mbante këtë emër, ku njerëzit vendosnin dryna për të simbolizuar dashuritë e tyre. Në nëntor të vitit 2021, drynat u hoqën dhe ura humbi epitetin që kishte mbajtur për gjashtë vite me radhë, duke iu kthyer emrit të saj të mëparshëm.



Fig.38 Ura e Naletit

4.10 URA E RINISË (25 MAJI)

Ura e Rinisë apo 25 Majit gjendet pranë Kroit të Bimbashit në Prizren dhe e mori emrin e saj nga data e përrimit dhe hapjes për komunikacion më 25 maj 1980. Kjo urë ndodhet mbi lumin Lumëbardh, dhe nën të rrjedh paralelisht proi (jazi) i Mullirit të Tabakhanes, i cili ndahet nga ujërat e lumit përmes një pende të thjeshtë. Penda, e vendosur disa metra më lart, është ndërtuar sipas traditës së hershme të mullinjxhinjve të Prizrenit dhe është e fundit e këtij lloji që ka mbetur në shtratin e Lumëbardhit.

Para ndërtimit të kësaj ure, në këtë pikë nuk

kishte ura lidhëse, dhe për këtë arsye ndjehej një nevojë e kahershme për një kalim të tillë. Aktualisht, ura shërben si arteria kryesore që lidh dy hapësirat urbane të Prizrenit, të ndara nga Lumëbardhi.

Ura është ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore teknike, me konstruksion të fortë prej beton-armature dhe me anësore metali të salduar. Struktura e urës pasqyron një krijimtari të qëlluar, duke shtuar një element modern në thesarin e pasur të kulturës materiale të qytetit të lashtë të Prizrenit.



Fig.39. Ura e Rinisë (25 Maji) M.Shukriu



Fig.40. Ura e Rinisë (25 Maji)

4.11 URA E BELEDIJES

Kjo urë, e vendosur pak më poshtë se ndërtesa e Beledijes (Bashkisë së qytetit, më vonë Këshillit Popullor), ka një histori interesante dhe të veçantë në kuadër të Prizrenit. Ura e Beledijes duket të jetë njëra nga urat më të vjetra të qytetit. Në vakëfnamen e Kukli beut (1538) kjo urë përmendet si ura e Suxhudi-të që ishte një poet i njohur që ka jetuar në fund të shekullit XV dhe fillim të shekullit XVI.

Sipas legjendës, të interpretuar nga tabakxhiu i njohur prizrenas, Zait Pula, ura përshkonte zonën ku nga kjo urë deri tek ajo e Suzi Çelebisë, ndodheshin kthinat e shumta të punëtorive të tabakëve të ngritura mbi drunj të ngulitur në Lumëbardh. Këto kthina u shkatërruan tërësisht gjatë vërshimeve të vitit 1726.

E njohur edhe si "Ura e Hekurit" (tr. Demirli Köprü), ajo dallonte nga urat e tjera për anësoret e saj prej hekuri të farkuar dhe transversalet konstruktive. Konstruksioni i saj kishte një fundament prej guri që krijonte një thepisje në drejtim të kundërt të rrjedhës së lumit. Për shkak të rëmojeve të ujërave që rrezikonin ekzistencën e urës, pjesa e poshtme e fundamentit u përforcua në vitin 1964.

Në vitin 1983, gjatë përgatitjeve për hapjen e Muzeut të Revolucionit (7 korrik 1964), ura u nënshtrua përmirësimeve, ku u vendosën anësore të tjera prej hekuri të salduar dhe u asfaltua dyshemeja. Sot, ura shërben vetëm për komunikacion të lehtë, duke mbajtur ende në vete historinë dhe traditën e qytetit të vjetër të Prizrenit.



Fig.41 Ura e Beledijes (burimi: M.Shukriu 1996)



Fig.42 Ura e Beledijes

4.12 URA E SUZI ÇELEBISË

Ura gjendet pranë Xhamisë së "Suzi Çelebisë" dhe njihet gjithashtu me emrin "Ura e Tabakhanes", pasi lidhte kompleksin e zejtarisë dhe lëkure përpunimit, të njohur edhe jashtë vendit. Ura u ndërtua nga Suzi Çelebia në vitin 1513, por supozohet se një urë ekzistonte edhe më parë.

Sipas analizave të vizatimit të vitit 1928 nga I. Ivanoviq, fotografisë së vitit 1962, dhe shqyrtimeve në terren të harkut të vogël të mbetur, ura ishte ndërtuar me gurë dhe kishte tri harqe: një të madh në mes dhe dy më të vegjël anash. Dyshemeja ishte e shtruar me kalldrëm turk, ndërsa muret anësore ishin prej gurësh të gdhendur, të përforcuar me shufra hekuri (klaumfa). Për shkak të mbylljes së pjesshme të harqeve dhe mbushjeve, harku i mesëm dhe njëri anësor u rrënuan nga vërshimet, para ose pak pas Luftës së Parë Botërore.

Në vizatimin e vitit 1928, dëshmohet ngritja e

konstruksionit prej druri në pjesët e rrënuara, i cili, me meremetime të shumta, qëndroi deri në vitin 1964, kur u rrënuar pothuajse tërësisht. Në të njëjtin vit, ura u rindërtua me beton-armaturë, përfshirë pjesën e epërme të harkut verior, anësoret prej hekuri të salduar, dhe dyshemeja u shtrua me asfalt. Rindërtimi siguroi qëndrueshmërinë ndaj vërshimeve dhe një kapacitet transporti deri në 15 ton.

Duhet theksuar se rikonstruksioni i Urës së Suzi Çelebisë nuk u realizua në mënyrë të duhur, duke cenuar vlerat e një objekti të kulturës materiale. Së pari, nuk u krye një studim historik adekuat, madje as i pjesës së trashëguar të urës, dhe së dyti, projektimi u bë ad hoc, vetëm për të siguruar transportin e nevojshëm. Ky cenim i një vlere kulturore është pasojë edhe e mungesës së një akti zyrtar për ta vlerësuar urën si përmendore kulturore.



Fig.43. Ura e Suzi Çelebisë (Tabakhanes) 1996 M.Shukriu

Studimi dhe projektimi i rikonstruksionit të Urës së Suzi Çelebisë do t'i rikthente qytetit një vlerë të çmuar të kulturës materiale dhe do të ishte një kthim borxhi ndaj veprave që krijoi ky intelektual dhe poet i madh nga Zerreni (Prizreni).

Megjithatë, ndjenjat euforike të ndërlidhura me mungesën e vëmendjes ndaj trashëgimisë dhe kulturës nga ana e disa udhëheqësve, të cilët nuk shfaqin ndjeshmëri ndaj vlerave historike (duke ndjekur parimin "historia fillon nga viti 1999"), çuan në rrënimin e plotë të urës në vitin 2005. Gjatë këtij procesi, edhe harku i vetëm origjinal i mbetur u hoq për t'i lënë vendin një ndërtese të re prej guri, të konceptuar si "më e vjetër se origjinali". Kjo ndërhyrje joautentike, e cila pretendonte të ruante vlerat historike të urës, përkundrazi, cenoi integritetin e saj si një monument i trashëgimisë kulturore.



Fig.44. Ura e Suzi Çelebisë (Tabakhanes)

4.13 URA E DRURIT

Ura gjendej midis Urës së Suzi Çelebisë dhe Urës së Kaçanikut. Ajo u ndërtua rreth vitit 1941 dhe shërbente për të ndërlidhur brigjet e Lumëbardhit në kompleksin e spitalit. Kjo urë ishte funksionale deri në vitin 1964, periudhë gjatë së cilës spitali funksiononte në këtë zonë të qytetit. Për urën nuk ka shumë informata, dhe foto vetëm se dihet që ura nuk është më në vendin e mëparshëm dhe qytetarët për lëvizjen nga një breg në tjetrin e bëjnë duke e shfrytëzuar urën e Suzi Çelebisë dhe atë të Kaçanikut.

4.14 URA E KAÇANIKUT

Kjo urë lidhet me rrugët "Kaçaniku" në bregun jugor të Lumëbardhit dhe "Bajram Curri" në bregun e kundërt të lumit, në zonën e njohur dikur si "Troshan mëhalla". Duke u bazuar në fundamentet e trashëguara, sidomos ato në pjesën e mesme dhe jugore, mund të thuhet se ura u ndërtua midis dy luftërave botërore. Nën pjesën veriore të urës kalonte përroi i mullirit të Haxhi Hasan Beut, i cili humbi funksionin pas shkatërrimit të mullirit të këtij qytetari të nderuar. Fundamentet e urës janë ndërtuar prej gurëve të lidhur me suva, ndërsa pjesa e sipërme ishte prej druri. Pas shkatërrimit të kësaj pjese gjatë viteve 1945-1950, kur mbetën vetëm themelet e urës, në vitin 1964 u ndërtua pjesa e sipërme me beton-armaturë, ndërsa anësoret u ndërtuan me gypa të ujësjellësit.

Për shkak të ndryshimeve në nivel midis rrugës "Bajram Curri" dhe urës, kjo e fundit u ndërtua ekskluzivisht për këmbësorët, veçanërisht për punëtorët e zonës industriale që banonin në pjesën jugperëndimore të qytetit, duke pasur një gjerësi prej 2.5 metrash.

Ura e re, në dallim nga ajo e vjetra, është shumë më e qëndrueshme dhe funksionale për qarkullimin e automjeteve. Ajo ka një bazament të fortë dhe është një strukturë shumë e rëndësishme, si për trafikun ashtu edhe për komunitetin që banon në këtë pjesë të qytetit. Ura gjithashtu është e pajisur me rrethoja të sigurta prej gypash cilindrikë, duke garantuar sigurinë e këmbësorëve që e përdorin atë.



Fig.45 Ura e Kaçanikut (burimi: M.Shukriu 1996)



Fig.46 Ura e Kaçanikut

4.15 URA E BUZAGILLËKUT



Fig.47 Ura e Buzagillëkut (M.Shukriu 1996)

Kjo urë, e vendosur në skaj të hapësirës jugperëndimore të Prizrenit, u ndërtua në vitin 1930, gjatë realizimit të rrugës që lidhte qytetin me kufirin shqiptar. Në këtë pikë, nuk ka të dhëna që sugjerojnë ekzistencën e një ure më të hershme. Fillimisht, ura ishte e ndërtuar prej druri, me një bazament të fortë në mes të Lumbardhit, dhe më vonë, në vitin 1964, u rindërtua me beton-armaturë. Ndërhyrja përfshiu edhe përforcimin e anësoreve dhe vendosjen e gypave të ujësjellësit, të cilët ishin pjesë e strukturës së saj.

Ura është e ngushtë dhe mund të përballojë mjete transporti me peshë deri në 50 ton, si dhe ka dy trotuare të ndara për këmbësorët. Emërtimi i saj vjen nga toponimi "Buzagillëk," i cili përket si "vend i viçave". Kjo urë ka luajtur një rol tejet të rëndësishëm për qytetin, si në të kaluarën ashtu edhe në ditët e sotme. Më herët, ajo ishte veçanërisht e rëndësishme për bujqit, pasi anën tjetër të urës e përbënin toka bujqësore, të cilat ata i përdornin për punimin e tokës. Ura u shërbente bujqve si mjet kryesor për të pasur qasje në pronat e tyre bujqësore, duke lehtësuar kështu veprimtaritë e tyre bujqësore dhe lidhjen me pjesën tjetër të qytetit.

Në anën jugperëndimore të urës, në vitin 1966, u instalua një ujësjellës si pjesë e unazës së furnizimit me ujë të zonës urbane dhe industriale të qytetit. Ky ujësjellës ishte një pjesë kyçe e rrjetit të ujësjellësit që përfundonte tek Ura e Rinisë, duke ndihmuar në mbylljen e unazës së furnizimit në zonën e rrafshit të qytetit.

Ura është rindërtuar diku pas vitit 2004 dhe ka humbur vlerën si ura e fundit në vazhden e historisë së vjetër të qytetit. Ura ende vazhdon të shërbejë për qytetarët, duke mundësuar kalimin si për këmbësorët ashtu edhe për mjetet automobilistike. Struktura e saj është e ngjashme me atë të urës së Kaçanikut, por dallimi kryesor qëndron në faktin se kjo urë është më e gjerë, duke lejuar lëvizjen e automjeteve në dy kahe. Përgjatë urës, janë ndërtuar shumë banesa dhe janë hapur një numër i madh lokalesh, duke e bërë këtë zonë më të urbanizuar dhe të frekuentuar.



Fig.48 Ura e Buzagillëkut

5. URAT E REJA TË PRIZRENIT

Gjatë dy dekadave të fundit, përgjatë Lumëbardhit të Prizrenit janë ndërtuar shtatë ura të reja që plotësojnë nevojat e qytetarëve për kalimin nga një anë e lumit në tjetrën. Këto ura kanë një funksion thelbësor për jetën e përditshme, duke lidhur rrugë dhe zona të ndryshme urbane. Nga këto shtatë ura, tri janë ndërtuar nga biznese private për të lehtësuar qarkullimin e klientëve të tyre. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në ndërlidhjen e zonave tregtare dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të zonave përreth. Këto ura kryesisht përbëhen nga konstruksione metalike me bazamente prej druri, duke reflektuar një stil të thjeshtë dhe funksional që i përgjigjet më së miri qëllimit të tyre. Një nga shembujt më të rëndësishëm është Ura e Mullirit të Dehirëve/Hapçive, e cila u ndërtua për të zëvendësuar urën e vjetër dhe për t'i shërbyer qytetarëve.

Kjo urë është pjesë e shtegut nga Marashi deri te Kalaja e Prizrenit dhe, së bashku me një tjetër pranë saj, si dhe urën afër parkut të qytetit, janë ndërtuar gjatë të njëjtës periudhë me teknika të ngjashme. Ato janë projektuar për të siguruar një kalim të sigurt për këmbësorët, duke ruajtur një pamje harmonike me natyrën përreth.

Këto ura nuk janë vetëm elemente funksionale të qytetit, por edhe një shprehje e mënyrës se si Prizreni ka evoluar, duke përqafuar zhvillimin modern pa lënë pas trashëgiminë kulturore që e karakterizon.

Ndryshe nga këto, ura pranë restorantit "River Hill," e ndërtuar në vitin 2019, është krejtësisht prej betoni dhe ka një shtyllë të vendosur në mes të lumit. Megjithatë, ndërtimi i kësaj ure nuk harmonizohet me ambientin e zonës ku ndodhet, duke krijuar një kontrast të dukshëm me mjedisin që gjendet përreth.



URA E KAMPIT



URA E RIVER HILL



URA NATYRA



URA ANDRRA



URA TE ISH PISHINA E QYTETIT



URA TE RESTORANT MARASHI



URA TE PARKU I QYTETIT



6. PËRMBLEDHJA E INTERVISTAVE ME EKSPERTËT

Urat e Prizrenit kanë një rëndësi të madhe historike, kulturore dhe funksionale, duke qenë dëshmitare të kalimit të kohës dhe ndryshimeve në qytet për më shumë se dy mijë vjet. Ato nuk kanë shërbyer vetëm si elemente infrastrukturore për të lidhur pjesët e ndryshme të qytetit, por kanë qenë gjithashtu simbole të identitetit lokal, duke përfaqësuar një pjesë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe kulturor të Prizrenit. Gjatë periudhës osmane, urat luanin një rol të veçantë në lidhjen midis pjesëve të qytetit dhe në lehtësimin e tregtisë lokale. Kjo periudhë shënoi ndërtimin e urave të tilla si "Ura e Suzi Çelebisë", e ndërtuar në vitin 1513. Kjo urë, e njohur gjithashtu si Ura e Tabakhanes, kishte tri harqe prej guri dhe dyshe me shtruar me kalldrëm turk, duke lidhur një kompleks zejtarësh që merreshin me përpunimin e lëkurës. Për fat të keq, përmbytjet e shekullit XX dhe mungesa e mirëmbajtjes shkaktuan dëme të konsiderueshme, duke zhdukur të gjitha elementet arkitekturore origjinale të saj.

"Ura e Gurit", një tjetër monument i rëndësishëm i Prizrenit, u ndërtua në periudhën osmane dhe ishte e lidhur me rrugën kryesore të qytetit. Kjo urë kishte një funksion të madh strategjik dhe ekonomik, duke lidhur Prizrenin me qytetet e tjera të Kosovës dhe rajonit. Përmbytjet e mëdha të vitit 1979, që shkaktuan rrënimin e urës dhe dëmtimin e gurëve të saj të gdhendur, vështirësuan kalimin për banorët dhe bllokuan pjesërisht jetën e qytetit. Rikonstruktimi që pasoi në pranverën e vitit 1980 nuk arriti të ruante plotësisht pamjen e saj origjinale, duke humbur një pjesë të vlerës arkitekturore të mëparshme. Një tjetër urë e rëndësishme është "Ura e Arastës", që shërbente si një pazar mbi ujë dhe ishte një ndër shembujt e rrallë të këtij koncepti në rajon. Duke mbajtur dyqane në të dy anët, kjo urë ishte jo vetëm një kalim, por edhe një

qendër ku zhvillohej tregtia e përditshme. Kjo veçori unike e bën atë të krahasueshme me urat e njohura si Ponte Vecchio në Firence dhe Ura Irgandı në Bursa të Turqisë. Megjithëse ka kaluar nëpër dëmtime të shumta dhe rinovime të njëpasnjëshme për shkak të zjarreve dhe përmbytjeve, ura aktuale paraqitet më e thjeshtë dhe larg shkëlqimit që kishte dikur.

"Ura e Buzagillëkut", e ndërtuar për të lidhur zonat bujqësore me pjesët e banuara të qytetit, ka luajtur një rol të rëndësishëm për fermerët, duke u shërbyer atyre për të lëvizur lirshëm midis arave dhe shtëpive të tyre. Me zhvillimin urban dhe ndërtimin e banesave të reja pranë kësaj ure, janë shfaqur shqetësime për ngushtimin e shtratit të lumit dhe për harmoninë vizuale të zonës.

Në dekadat e fundit, ndërtimi i urave të reja si "Ura e Lidhjes" dhe "Ura e Therandës" ka ngjallur debate për mungesën e harmonizimit me arkitekturën tradicionale të Prizrenit. Këto ura shpesh kritikohen për mungesën e estetikës dhe për mos përmbytjen e standardeve që i përshtaten mjedisit historik të qytetit. Ura e Therandës, në veçanti, ndodhet në një gjendje të mjerueshme për shkak të mungesës së investimeve dhe përkujdesjes nga autoritetet lokale.

Një tjetër urë me rëndësi historike është "Ura e Naletit", që lidhet me një legjendë të dhimbshme ku thuhet se një nuse, e dëshpëruar për shkak se nuk mund të martohej me dashurinë e saj, hodhi veten në ujërat e Lumbardhit. Ura është rinovuar disa herë, por sot ngrihen pyetje nëse forma aktuale është në përputhje me kulturën dhe traditën arkitekturore të Prizrenit.

Në aspektin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara, disa ura si "Ura e Gurit" dhe "Ura e Therandës" nuk ofrojnë standardet e duhura. Edhe pse janë bërë disa përpjekje për të përmirësuar qasjen me ndërtimin e pjerrinave, ato nuk janë realizuar sipas

standardeve të nevojshme për t'u siguruar që çdo person të ketë qasje të barabartë. Nga ana tjetër, "Ura e Rinisë" është vlerësuar për funksionin e saj, duke ofruar lidhje të mirë për ndërtesat publike të qytetit.

Rikonstruktimi, mirëmbajtja dhe adaptimi i urave ekzistuese janë kritike për ruajtjen e vlerave të tyre historike dhe kulturore. Rekomandohet të ndërmerren masa për të përmirësuar infrastrukturën, siç janë: vendosja e shenjzimeve informuese për historinë dhe rëndësinë e urave, harmonizimi arkitektonik i urave të reja me stilin tradicional të qytetit, dhe përkujdesja e rregullt për mirëmbajtjen e urave. Gjithashtu, është e rëndësishme që të zhvillohen plane për integrimin e urave në aktivitete promovuese turistike dhe kulturore, duke përfshirë guida dhe shëtitje të organizuara që tërheqin vizitorët dhe theksojnë rëndësinë e tyre për historinë dhe identitetin e Prizrenit.

Për ruajtjen e urave të vjetra dhe promovimin e Prizrenit në itineraret turistike, është thelbësore të ndërmarrim veprime konkrete për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e tyre. Rindërtimi i urave historike, ku ekzistojnë të dhëna të dokumentuara, është një hap i rëndësishëm që përfshin identifikimin e pjesëve të dëmtuara dhe realizimin e projekteve restauruese që respektojnë strukturën origjinale dhe materialet historike. Zhvillimi i një programi të rregullt mirëmbajtjeje do të sigurojë që urat të mbeten të qëndrueshme dhe të sigurta, përveç instalimit të mekanizmave për monitorimin e erozionit nga lumenjtë.

Për të promovuar vlerën kulturore dhe historike të urave, është e nevojshme të vendosen tabela informative që ofrojnë histori dhe arkitekturë, si dhe të inkurajohen udhërrëfyesit turistikë të përfshijnë legjenda dhe histori lokale. Organizimi i eventeve kulturore pranë urave do të ndihmojë

kulturore pranë urave do të ndihmojë gjithashtu në tërheqjen e vizitorëve, duke krijuar një kontekst historik dhe artistik. Integrimi i urave të reja në peizazhin turistik kërkon që ato të përshtaten me arkitekturën historike dhe të mos krijojnë kontraste vizuale të mëdha.

Sipas të intervistuarve përfshirja e komunitetit dhe edukimi mbi rëndësinë e urave janë po ashtu të domosdoshme, organizimi i fushatave për edukimin e komunitetit mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe angazhimi i nxënësve në projekte mësimore do të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për vlerën historike dhe kulturore të urave.

Inicimi i partneriteteve me sektorin privat është një mënyrë efektive për të siguruar mbështetje financiare për projekte të mirëmbajtjes dhe zhvillimit të urave, duke kontribuar kështu në ruajtjen e këtyre objekteve të rëndësishme dhe në zhvillimin e turizmit në Prizren.



7. REZULTATET E PYETËSORIT ME QYTETARË

EC Ma Ndryshe për ta plotësuar më shumë këtë hulumtim ka realizuar edhe një anketë me qytetarët e Prizrenit. Kjo anketë kishte për synim eksplorimin dhe dokumentimin e memories kolektive të qytetarëve në lidhje me urat historike dhe moderne të qytetit. Me anë të anketës janë mbledhë dhe analizuar perceptimet, përvojat dhe kujtimet personale të qytetarëve, duke nxjerrë kështu në pah rëndësinë kulturore dhe sociale që urat kanë luajtur në jetën e përditshme të Prizrenit. Përmes këtij hulumtimi, EC Ma Ndryshe synon të promovojë vlerat si dhe ruajtjen e këtyre urave si pjesë e trashëgimisë së çmuar kulturore të qytetit.

7.1 PËRFUNDIMET E PYETËSORIT ME QYTETARË:

Anketa mbi perceptimin e qytetarëve për urat e Prizrenit nxori në pah rëndësinë e këtyre strukturave si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe jetës së përditshme të qytetit. Ura e Gurit është vlerësuar si më e rëndësishmja nga shumica dërrmuese e të anketuarve, ndërsa urat e tjera zënë një rol më modest në vlerësimet e tyre. Pavarësisht lidhjes së thellë të qytetarëve me urat, një pjesë shumë e vogël ka rrëfime ose ngjarje personale të lidhura me to, duke sugjeruar se simbolika e tyre tejkalon përvojat individuale dhe qëndron më shumë si një element kolektiv i kulturës dhe historisë.

Qytetarët theksojnë rëndësinë e urave si pika sociale dhe kulturore, por gjithashtu kanë vënë në dukje ndryshimet që kanë ndodhur me kalimin e viteve. Rinovimet, ndriçimet dhe ndërhyrjet estetike shpesh shihen me skepticizëm, pasi disa qytetarë besojnë se këto ndërhyrje kanë cenuar autenticitetin historik të urave. Në veçanti, Ura e Gurit dhe Ura e Arastës janë përmendur si shembuj të ndryshimeve që kanë ndikuar në identitetin e tyre tradicional.

Një pjesë e madhe e qytetarëve shpreh mbështetje për ruajtjen e urave në gjendjen e tyre origjinale dhe kërkon një qasje më të kujdesshme në mirëmbajtje dhe restaurim, duke përfshirë komunitetin në procesin e planifikimit. Rëndësia e urave si pjesë e trashëgimisë kulturore është vlerësuar shumë, me një mbështetje të madhe për stilin

tradicional në ndërtimin e urave të reja. Për më tepër, sugjerimet për përmirësimin dhe ruajtjen përfshijnë masa si mirëmbajtja e rregullt, mbrojtja me ligj dhe edukimi i komunitetit mbi rëndësinë e tyre kulturore dhe historike.

Në përgjithësi, rezultatet e anketës nënvizojnë rolin kyç të urave në identitetin urban të Prizrenit, duke sugjeruar që çdo ndërhyrje në to duhet të bëhet me kujdes dhe respekt për historinë dhe trashëgiminë e tyre.



7.2 ANKETË ME QYTETARËT E PRIZRENIT: MEMORIA KOLEKTIVE DHE RËNDËSIA E URAVE

EC Ma Ndryshe është duke realizuar një hulumtim për urat e Prizrenit, me synimin për të eksploruar dhe dokumentuar memorien kolektive të qytetarëve në lidhje me urat historike dhe moderne të qytetit. Anketa ka për qëllim të mbledhë dhe analizoj perceptime, përvoja dhe kujtime personale të qytetarëve, për të nxjerrë në pah rëndësinë kulturore dhe sociale që urat kanë luajtur në jetën e përditshme të Prizrenit. Përmes këtij hulumtimi, EC Ma Ndryshe synon të promovojë vlerat si dhe ruajtjen e këtyre urave si pjesë e trashëgimisë së çmuar kulturore të qytetit.

Gjinia

M

F

Mosha

18-24

25-34

35-44

45-54

55-64

65+

CILA URË E PRIZRENIT KA RËNDËSI MË TË MADHE PËR JUVE?

01

A) URA E GURIT

B) URA E SUZI ÇELEBISË

C) URA E RINISË/BEQARËVE

F) URA E NALETIT/DASHURISË

TJETËR (SPECIFIKONI) _____

A KENI NDONJË RRËFIM APO NGJARJE TË VEÇANTË QË NDËRLIDHET ME NDONJËRËN NGA URAT E PRIZRENIT?

02

A) PO

B) JO

NËSE PO, A MUND TË NA JEPNI MË SHUMË DETAJE PËR RRËFIMIN APO NGJARJEN?

3. SI KANË NDIKUAR URAT NË ZHVILLIMIN E JETËS SOCIALE TË PRIZRENIT?

03

A) JANË PIKA TË RËNDËSISHME SOCIALE DHE KULTURORE

B) SHËRBEJNË KRYESISHT PËR QARKULLIM DHE TRANSPORT

C) NUK KANË PASUR NDIKIM TË MADH

D) TJETËR (SPECIFIKONI)

04 A KENI VËREJTUR NDRYSHIME TË MËDHA NË URAT E PRIZRENIT GJATË VITEVE?
A) PO, SHUMË NDRYSHIME
B) PO, DISA NDRYSHIME
C) JO, NUK KANË NDRYSHUAR SHUMË
NËSE PO, A MUND TI SPECIFIKONI NDRYSHIMET QË KANË PASUR NDIKIM NË RUAJTJEN E KËTYRE URAVE?

05 CILA URË JU PËLQEN MË SË SHUMTI PËR PAMJEN DHE FUNKSIONALITETIN E SAJ?
A) URA E GURIT
B) URA E MARASHIT
C) URA E RINISË
D) NJË TJETËR (SPECIFIKONI)_____

06 ÇFARË MENDIMI KENI PËR URAT E REJA QË JANË NDËRTUAR GJATË DY DEKADAVE TË FUNDIT?
A) MË PËLQEJNË, JANË MODERNE DHE FUNKSIONALE
B) NUK JANË NË HARMONI ME QYTETIN DHE MJEDISIN PËRRETH
C) NUK E DI

07 A MENDONI SE DISA NGA URAT E VJETRA KANË NEVOJË PËR RESTAURIM OSE MIRËMBAJTJE?
A) PO, DISA PREJ TYRE KANË NEVOJË PËR KUJDES
B) JO, JANË NË GJENDJE TË MIRË
C) NUK E DI
NËSE PO, SIPAS JUSH CILAT JANË ATO URA QË KANË NEVOJË PËR KUJDES?

08 A PREFERONI QË URAT E REJA TË NDËRTOHEN SIPAS STILIT TRADICIONAL TË QYTETIT?
A) PO, DUHET TË NDJEKIN STILIN E VJETËR TË PRIZRENIT
B) JO, MODERNIZIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM
C) NUK KA RËNDËSI PËR MUA

09 9. A DUHET TË PËRFSHIHET KOMUNITETI GJATË PLANIFIKIMIT TË NDËRHYRJEVE NË URAT EKZISTUESE, APO GJATË PLANIFIKIMIT PËR NDËRTIMIN E URAVE TË REJA? ?
A) PO, DUHET TË NDJEKIN STILIN E VJETËR TË PRIZRENIT
B) JO, MODERNIZIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM
C) NUK KA RËNDËSI PËR MUA

10

1SA ËSHTË E RËNDËSISHME QË URAT E PRIZRENIT TË MBROHEN DHE TË RUHEN SI PJESE E TRASHËGIMISË KULTURORE?

- A) SHUMË E RËNDËSISHME
- B) MESATARISHT E RËNDËSISHME
- C) JO SHUMË E RËNDËSISHME

11


A KENI SUGJERIME SE SI URAT E PRIZRENIT MUND TË PËRMIRËSOHEN APO TË RUHEN MË MIRË?

- A) PO
 - B) JO
 - C) NUK E DI
- NËSE PO, CILAT JANË SUGJERIMET E JUAJA?**
-

8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

8.1 PËRFUNDIME

- Urat e Prizrenit, si pjesë e infrastrukturës së tij historike, mbajnë një rëndësi të madhe kulturore dhe arkitekturore. Shumë prej këtyre urave kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme historike, si periudha osmane dhe periudha jugosllave, duke reflektuar transformimin ekonomik, kulturor dhe strategjik të qytetit.
- Urat e gurit, si ato në Kërk-bunar dhe ura e famshme e Gurit, kanë një vlerë të madhe historike dhe janë shembuj të sofistikimit të teknologjisë së ndërtimit të asaj kohe.
- Urat e ndërtuara në shekullin XX dhe XXI tregojnë një përparim në përdorimin e materialeve moderne si betoni dhe çeliku. Këto ura janë ndërtuar për të përmbushur nevojat e trafikut urban të sotëm, por disa prej tyre kanë sjellë edhe një ndikim estetik që nuk përputhet gjithmonë me karakteristikat historike të qytetit.
- Urat moderne prej metalit dhe drurit janë ndërtuar për të përmirësuar qarkullimin brenda qytetit dhe për të plotësuar nevojat e rritura të komunitetit, siç shihet tek parku i qytetit dhe urat te shtegu për ne kalanë e Prizrenit.
- Një numër urash, si Ura e Vjetër në Kërk-bunar dhe Ura e Gurit, janë nën mbrojtje institucionale për shkak të vlerës së tyre historike dhe arkitekturore. Megjithatë, disa ura të tjera që kanë rëndësi historike, si Ura e Lidhjes, Ura e Therandës (Arasta) kanë vuajtur nga rikonstruksione jo adekuate dhe mungesa e studimeve të thelluara.
- Urat e Prizrenit, përveç funksionit të tyre si kalime të sigurisë, kanë qenë gjithashtu pika kyçe për zhvillimin tregtar dhe komunikimin mes banorëve të zonave të ndryshme të qytetit, duke krijuar një ndjesi të fortë lidhjeje midis komuniteteve urbane dhe rurale.



8.2 REKOMANDIME

- Duhet të ndërmerren përpjekje më të mëdha për të restauruar urat historike në Prizren, duke përdorur teknologji moderne, por gjithmonë duke ruajtur origjinalitetin e tyre arkitekturor dhe kulturor. Një shembull që restaurimi është e domosdoshme është ura e vjetër e gurit e cila e gëzon statusin e mbrojtur nga shteti po që nuk është intervenuar nga institucionet.
- Institucionet lokale dhe qendrore duhet të sigurojnë që të gjitha urat historike të jenë nën mbrojtje dhe të konsiderohen si asete me vlerë të veçantë kulturore. Ato duhet të shpallen dhe të emërohen si monumente kulturore, me kritere të qarta për ndërhyrjet dhe restaurimet që ruajnë autenticitetin dhe vlerën e tyre historike për brezat e ardhshëm.
- Rikonstrukcioni duhet të bëhet në bazë të studimeve të detajuara historike për të siguruar që këto ura të ruajnë vlerat e tyre kulturore dhe estetike.

Ndërsa urat moderne plotësojnë nevojat e sotme për qarkullim, ato duhet të projektohen me një vëmendje më të madhe ndaj harmonisë me peizazhin kulturor dhe natyror të qytetit. Për shembull, dizajnet metalike dhe elementet prej druri ose urat me gur të cilat mund të integrohen më mirë në peizazhin historik.


- Planifikimi urban duhet të marrë parasysh nevojën për të ruajtur urat historike dhe për t'i përfshirë ato në zhvillimin urbanistik të qytetit.
- Krijimi i ndërgjegjesimit të qytetarëve dhe vizitorëve mbi rëndësinë e urave të Prizrenit, si për aspektin kulturor ashtu edhe për infrastrukturën e përditshme, është thelbësore. Përmes projekteve edukative dhe aktiviteteve publike, siç ishte performanca publike "I AM MONUMENT" në urën e Therandës, mund të krijohet një lidhje më e thellë mes komunitetit dhe trashëgimisë urbane.
- Është e rëndësishme që urat, si ato të reja ashtu edhe ato të vjetra, të monitorohen rregullisht për të shmangur degradimin dhe për të siguruar që ato të jenë funksionale dhe të sigurta për qytetarët. Institucionet duhet të krijojnë një plan të rregullt mirëmbajtjeje për urat e Prizrenit, duke përfshirë ndjekjen e masave parandaluese ndaj përmbytjeve dhe dëmtimeve natyrore.
- Urat e Prizrenit, sidomos ato historike, mund të promovohen më shumë si pjesë e itinerareve turistike të qytetit, duke i dhënë vizitorëve mundësinë të përjetojnë historinë dhe trashëgiminë kulturore të qytetit nëpërmjet këtyre strukturave unike.
- Hartimi i projektit të regjenerimit urban për: Brigjet e lumit Lumëbardhi (PMQH)

9. GALERIA ME FOTO TË VJETRA TË URAVE TË PRIZRENIT

URA E LIDHJES (1948)



URA E GURIT (1954)



URA SUZIUT



URA E VJETËR E GURIT




URA E MARASHIT (1939)



URA E THERANDËS



URA E MANASTIRIT TË KRYEENGJUJVE




URAT E PRIZRENIT



10. KOORDINATAT E URAVE

NR	URAT	KOORDINATA
01	URA E VJETËR NË KËRK-BUNAR	42.194356, 20.773950
02	URA E GURIT	42.209617, 20.740613
03	URA E MANASTIRIT TE KRYE ENGJËJVE	42.201040, 20.763172
04	URA E HIDROELEKTRANËS	42.201866, 20.761831
05	URA E JABLLANICËS	42.204364, 20.757374
06	URA E MULLIRIT TË DEHIRËVE/HAPÇIVE	42.207161, 20.753404
07	URA E MARASHIT	42.212386, 20.744500
08	URA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT	42.210863, 20.743832
09	URA E THERANDËS (ARASTËS)	42.209683, 20.741737
10	URA E NALETIT (KALTËRT)	42.209730, 20.739040
11	URA E RINISË (25 MAJI)	42.209905, 20.736630
12	URA E BELEDIES	42.210088, 20.735508
13	URA E SUZI ÇELEBISË	42.209715, 20.733605
14	URA E KAÇANIKUT	42.209713, 20.729885
15	URA E BUZAGILLËKUT	42.207367, 20.724138

LOKACIONET E URAVE TË PRIZRENIT



2. URA E GURIT

9. URA E THERANDËS (ARASTËS)

11. URA E RINISË (25 MAJI)

7. URA E MARASHIT

10. URA E NALETIT (KALTËRT)

12. URA E BELEDIES


8. URA E LIDHJES SHQIPTARE
TË PRIZRENIT



13. URA E SUZI ÇELEBISË

14. URA E KAÇANIKUT

15. URA E BUZAGILLËKUT



1. URA E VJETËR NË KËRK-BUNAR

3. URA E MANASTIRIT TE KRYE ENGJËJVE

4. URA E HIDROELEKTRANËS

5. URA E JABLLANICËS

6. URA E MULLIRIT TË DEHIRËVE/HAPÇIVE

11. BIBLIOGRAFIA

1. Muhamed Shukriu - Prizreni i Lashtë
2. Prizreni- Qytet përmendore - pasqyra e qytetit
3. Esat Haskuka - Ura, çarshia, xhamia dhe lagjja e Arasta
4. Esat Haskuka - Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve
5. Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës
6. <https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=4126>
7. <https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=9271>
8. <https://ecmandryshe.org/sq/lajmet/ura-e-kalter-e-dashurise>
9. <https://produzione.divisare.com/projects/304333-senat-haliti-architect-arasta-i-am-monument>
10. <http://spomenikulture.mi.sanu.ac.rs/spomenik.php?id=342>
11. <https://structurae.net/en/structures/alcantara-bridge>
12. <https://turismoroma.it/it/luoghi/ponte-santangelo>

Të intervistuarit:

1. Vesel Hoxhaj (Arkeolog)
 2. Jusuf Xhibo (Arkitekt)
 3. Enes Toska (GuideKS/Arkitekt)
 4. Nexhat Çoçaj (Historian)
 5. Fellanza Kirajtani (Historiane)
 6. Antigona Shestan (OPDMK)
 7. Alajadin Haskuka (Organizata Komunale e Pensionistëve, Prizren)
 8. Alihajdar Shuki (Pensionist)
-

12. PËR EC-IN


EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për pale të treta. Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen,
2. Qëndrueshmërinë, dhe
3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukëta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
 2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkë veprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
 3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
 4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.
-



Pamje nga lartë e trashëgimisë mbi Lumëbardh në zonën historike të qytetit
(Urat në fotografi: Ura e Therandës, Ura e Gurit, Ura e Naletit, Ura e Rinisë dhe Ura e Beledies)

www.ecmandryshe.org

